

burgim), rrethanat e kryerjes së veprës penale, pëlqimi i të dënuarit.

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë. Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

Pasoja nga mospërbushja e detyrimeve:

Me moskryerje të punës në mënyrë të rregullt nënkuptohet paraqitja me vonesë e mungesat pa arsye në punë apo mosrespektimi i rregullave për kryerjen, sjelljen dhe rendimentin në punë.

Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën e cila ka të drejtë të vendosë, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e detyrimeve, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg.”.



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)
Rruga “Sami Frashëri”
4 kullat, Seksioni 3, Ap. 1A
Tirana, Albania
Tel/Fax: +355 4 2258 442
Tel: +355 4 2253 114
Kutia Postare 69
E-mail: tlas@tlas.org.al
www.tlas.org.al

ederstudio.com



PEZULLIMI I VENDIMIT TË EKZEKUTIMIT ME BURGIM PËR KRYERJEN E NJË PUNE ME INTERES PUBLIK

5. LIRIMI ME KUSHT

Kusht kryesor, të ketë vuajtur jo më pak se:

- Gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- Dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- Tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim,
- 25 (njëzetëepesë) vjet për personat e dënuar me burgim të përjetshëm.

(Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje)

Kushte të tjera të rëndësishme ; të jetë arritur qëllimi i edukimit të tij, ndërsa për të dënuarit me burgim të përjetshëm kërkohet edhe “ mbajtja e një sjelljeje shëmbullore”.

Kushte përjashtuese:

Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje. Pasoja e ridënimit ; Lirimi para kohe me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

Ekzekutimi i vendimeve alternative



LIRIMI ME KUSHT

Prokurori është personi përgjegjës për ekzekutimin e çdo vendimi penal, përfshirë edhe vendimet alternative të dënimit me burgim. Por, në ekzekutimin e dënimeve alternative një rol të rëndësishëm luan “ shërbimi i provës”.

Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendieve alternative dhe bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore.

Shërbimi i provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personin e dënuar nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimeve alternative.

Në ekzekutimin e dënimit alternativ, shërbimi i provës mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe jep ndihmë në integrimin social të tij.



A MUND TË ZËVENDËSOHET DËNIMI ME BURGIM ?

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) dhe asgjë në këtë botim, në asnjë rrethanë, nuk do të vlerësohet si pasqyrim i pozicionit të Bashkimit Europian.



A mund të zëvendësohet DËNIMI ME BURGIM ?

Pas ndryshimeve që i janë bërë Kodit Penal me ligjin nr. 10023 datë 27.11.2008, të dënuarit me burgim kanë më shumë hapësira ligjore për të mos vuajtur dënimin me burgim duke e zëvendësuar atë me një dënim alternativ sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Ligj (Kodin Penal).

Cilat janë llojet e dënimeve alternative?

1. GJYSMËLIRI

-Kushti kryesor – dënim me burgim jo më shumë se një vit,
-Kushte të tjera të rëndësishme, detyrime që lidhen me punën, arësimin, aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor.

Gjysmëliria nuk përfaqëson shmangien e ekzekutimit me burgim por shtyrjen e këtij ekzekutimi për rrethanat që citoohen në ligj.

2. QËNDRIMI NË SHTËPI

-Kushti kryesor – dënim me burgim jo më shumë se dy vjet (ose pjesa e mbetur e dënimit me burgim është më pak se dy vjet)

-Kushte të tjera të rëndësishme:



GJYSMËLIRI

a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.

b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.

c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.

ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paafët nga ana shëndetësore.

d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësiive familjare.

Në këto raste për ekzekutimin e pjesës së mbetur të dënimit, *gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik.*

3. PEZULLIMI I VENDIMIT TE EKZEKUTIMIT ME BURGIM DHE VËNIA NË PROVË

-Kushti kryesor – dënim me burgim jo më shumë se 5 (pesë) vjet.

-Kushte të tjera të rëndësishme ;

-Rrezikshmëri e pakët e personit (të dënuarit),



QËNDRIMI NË SHTËPI

mosha, rrethanat e kryerjes së veprës, sjellja pas kryerjes së veprës, kushte shëndetsore apo mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat që lidhen me; familjen, shkollimin, punën.

-Kushti i rëndësishëm plotësues; të përmbushë detyrimet ndaj shërbimit të provës dhe të mos kryejë veprë tjetër penale.

Detyrimet gjatë periudhës së provës:

1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.
2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare."
3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.
4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.
5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.
6. Të mos frekuentojë vende të caktuara.
7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.
8. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.
9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.
10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.
11. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.
12. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.



PEZULLIMI I VENDIMIT TE EKZEKUTIMIT ME BURGIM DHE VËNIA NË PROVË

Detyrime plotësuese gjatë periudhës së provës:

- a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;
 - b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit."
- Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet dhe caktohet nga gjykata.

Pasojat nga mospërmbushja e detyrimeve të provës:

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës, nuk përmbush detyrimet siç është urdhëruar nga gjykata, apo kryen një veprë tjetër penale, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit."

4. PEZULLIMI I VENDIMIT TË EKZEKUTIMIT ME BURGIM PËR KRYERJEN E NJË PUNE ME INTERES PUBLIK

Kushti kryesor- dënim me burgim jo më të gjatë se 1 (një) vit,

Kushte të tjera të rëndësishme;
Rrezikshmëri e pakët e personit (të dënuarit me